

Tiranë, 20/11/2025

TERMAT E REFERENCËS

Emri: Instituti Liberal i Tiranës Pashko
Adresa: Rruga "Xhanfize Keko", nr. 56, Tiranë
Email: info@ilp-al.org
Afati i dorëzimit: 26/11/2025

SHËRBIM EKSPERT MARKETINGU ONLINE – FUSHATA “DIGI RINIA”

SFONDI

Instituti Liberal i Tiranës Pashko, gjatë periudhës shkurt - nëntor 2025, po zbaton Projektin: “DigiRinia - Aftësim dhe Përfshirje Dixhitale për Gjeneratën e Re”. Ky projekt synon të aftësojë dhe përfshijë të rinjtë në zhvillimin dixhital përmes aktiviteteve informuese, trajnimeve dhe pajisjeve teknologjike.

QËLLIMI I ANGAZHIMIT

Angazhimi i një eksperti që do të krijojë dhe menaxhojë postimet në rrjetet sociale, si dhe do të kryejë boost-e për rritjen e shikueshmërisë dhe angazhimit të të rinjve.

DETYRAT KRYESORE

- Menaxhimi i faqeve zyrtare të projektit (Facebook & Instagram).
- Krijimi i postimeve dhe përmbajtjes bazë (foto, video të shkurtra, tekste).
- Kryerja e boost-eve sipas planit të komunikimit.
- Raport i shkurtër mbi rezultatet e arritura.

KUALIFIKIMET E KËRKUARA

- Eksperiencë në marketing online dhe menaxhim rrjetesh sociale.
- Njohuri mbi përdorimin e Facebook/Instagram Ads.

DOKUMENTACIONI I KËRKUAR

- Ofertë financiare në lekë (me ose pa kostot e boost-eve).
- CV ose portofol i shkurtër.

VLERËSIMI I OFERTAVE

Ofertat do të vlerësohen mbi bazën e raportit çmim-cilësi dhe përputhshmërisë me specifikimet teknike. Ofertat që tejkalojnë buxhetin maksimal do të refuzohen automatikisht.

INFORMACION SHITESË

Autoriteti kontraktues ruan të drejtën të anulojë procedurën nëse nuk paraqiten oferta të përshtatshme, në rast ndryshimesh të nevojave apo për arsye të forcës madhore.

UDHËZIME PËR OFERTUESIT

Kur paraqesin ofertat e tyre, ofertuesit duhet të ndjekin të gjitha udhëzimet, format, termat e referencës, dispozitat kontraktuale dhe specifikimet e përfshira në këtë dosje prokurimi. Mosdorëzimi i një oferte që përmban të gjitha informacionet dhe dokumentet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar mund të çojë në refuzimin e saj.

Këto udhëzime përcaktojnë rregullat për paraqitjen, përzgjedhjen dhe zbatimin e kontratave të financuara në kuadër të kësaj thirrjeje për prokurim.

FURNIZIMI/SHËRBIMI I KËRKUAR

Furnizimet e kërkuara janë përshkruar në Termat e Referencës.

AFATET KOHORE

Afati për kërkesë për sqarime: **24.11.2025, ora 23:59**

Afati për dorëzimin e ofertave: **26.11.2025, ora 23:59**

(Të gjitha oraret janë përcaktuar sipas orës lokale të autoritetit kontraktues)

PJESËMARRJA DHE NËNKONTRAKTIMI

- Pjesëmarrja është e hapur për të gjithë.
- Nëse përdoret nënkontraktor, duhet të jepet emri, vlera dhe përqindja përkatëse në ofertën financiare.

PËRMBAJTJA E OFERTËS

Dokumentet duhet të jenë në **shqip**.

Oferta duhet të përmbajë:

- **Ofertën teknike** (CV ose link i faqes së ofertuesit)
- **Ofertën financiare** në lekë, sipas formatit të dhënë

PYETJE PARA AFATIT TË DORËZIMIT

- Pyetjet mund të dërgohen me email në: info@ilp-al.org deri më **26.11.2025**.
- Nuk do të zhvillohet takim apo vizitë në zyrë.

SHPENZIMET E OFERTUESIT

Shpenzimet për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës nuk rimbursohen.

VLERËSIMI I OFERTAVE

- Nuk parashikohet intervistë.
- Ofertat mbi buxhetin maksimal do të refuzohen.
- Përzgjedhja bëhet mbi parimin **çmim-cilësi**.

ETIKA DHE PRAKTIKAT E NDALUARA

- Çdo përpjekje për ndikim të padrejtë në procedurë do të çojë në përjashtim.
- Ndalohet konflikti i interesit dhe shpenzimet e pazakonta komerciale.

NËNSHKRIMI I KONTRATËS



- Ofertuesi fitues njoftohet dhe duhet të nënshkruajë kontratën brenda **30 ditëve**.

ANULIMI I PROCEDURËS

Autoriteti kontraktues mund të anulojë procedurën në raste të veçanta, si: mungesë ofertash të vlefshme, ndryshime të rëndësishme, forca madhore, tejkalim buxheti ose shkelje në proces.

FORMULARI I DORËZIMIT TË SHËRBIMIT

Aktiviteti 3.1: Organizimi i Fushatës Informuese dhe Ndërgjegjëse “DigiRinia”
Kodi: 4.7.4

Projekti: “DigiRinia-Aftësim dhe Përfshirje Dixhitale për Gjeneratën e Re”

Shuma totale e ofertës:

Nr.	Shërbimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Çmimi total
1	Ekspert per fushaten online.	Fee	1		

Nënshkruar në emër të Ekspertit

Emri & Mbiemri:

Firma:

